



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

317/20

Datë/Datum.

10.07.2020

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 317/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK” – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B - Pjesa e dytë” me nr. të prok:616-19-1015-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, më datën: 08.07.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prok: 616-19-1015-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prok: 616-19-1015-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues ekonomik “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 21.05.2020 me nr. 317/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë” me nr. të prok: 616-19-1015-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7,59,60,65 dhe neni 69 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni: 28, 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:11.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Përgjigje në Pretendimi nr. 1,** Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulte) në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). SHENIM Nëse tenderuesi është grup i OE-ik lideri i grupit duhet të plotësojë 60 % të vlerës së referencave”, dhe të dëshmitë dokumentare është kërkuar: “Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve”.

Duke u bazuar në paramasat e prezantuara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, si sqarime shtesë së bashku me kërkesën për rishqyrtim, ekspertja



teknike sqaron se kontratat e prezantuara të mirëmbajtjes, disa pozicione përfshin edhe punë të ngjashme e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë “Punë të ngjashme (ndërtim i ulte)”.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, lidhur me kontratat 183,449.69€ dhe 63,953.67€, eksperti shqyrtues sqaron se këto kontrata janë nënshkruar me 03.08.2016 dhe 04.10.2016, ndërsa raportet e pranimeve teknike janë me dt:20.12.2016 dhe 19.12.2016, për më tepërt mund të ju referohuni raporteve të dëshmuara më poshtë. Bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, si dhe duke pasur parasysh se kur është bërë njoftimi për kontratë, mendoj se këto raporte janë brenda në afatit “3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë)”.



Projekti: Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Merdar  
Investitor: Komuna e Podujevës  
Kontrata Nr. 61516086521 e datës 03.08.2016  
Vlera e kontratës: 183,449.69€  
Anëtar Kontrata: 10.738.00€ e datës 11.11.2016  
Kryeri i punimeve: Sh.p.k. "Integral" Prishtinë  
Data e përfundimit të raportit: 20.12.2016

#### RAPORTI PRELIMINAR I PRANIMIT TEKNIK TË PUNËVE TË KRYERA

Për vlerësimin e punëve të kryera në projektin: Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Merdar është formuar komisioni profesional në përzierje:

1. Ismet Kadriu, inzh. i dipl. i inzh. i rrugëve
2. Mirvete Jaha, inzh. i dipl. i ndërt. anëtar dhe
3. Gëzim Osman, inzh. i dipl. i ndërt. anëtar (përfaqësues nga M)

Komisioni në përzierje të plotë nisi punën e vetë më datën 20.12.2016, puna e komisionit në fillim u koncentrua në kontrollimin e dokumentacionit investivo-teknik, ditë më pas u nisën punët në kontrollimin nga Organi Mbrojtës dhe përfaqësuesit të punës kryesore të materialëve të.

Më pas, puna e komisionit vazhdoi në vendpunësim dhe ishte bërë kontrollimi i punëve të kryera dhe krahasimi i kushteve dhe sasive të ndërtuara me ato të prezantuara në barazim dhe parafundim të punëve dhe u kontratua me të vlerën. Se punët e kryera nga ana e Sh.p.k. "Integral" Prishtinë në kryerjen e projektit Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Merdar në Podujevë janë të kryera në përputhësi me kontratën dhe të pranueshme për komisionin andë i sugjeronet investitorit që të bëjë pagosën e vlerës së kontratës sipas raportit përfundimtar të paraqitur nga organi mbrojtës.

Komisioni për pranimit preliminar teknik u sugjeron D.P. që para se të bashkohet garancioni të vlerës kontraktore të bëhet edhe një herë rishikimi i punëve, në mënyrë që nëse ka dështim eventual ta përmbledhojë punën.

Organi mbrojtës:

Fatmir Latifi, i.d.a.

*[Signature]*

#### KOMISIONI

- 1) Ismet Kadriu i.d.a.
- 2) Mirvete Jaha, i.d.a.
- 3) Gëzim Osman i.d.a.

*[Signatures]*



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

Projekti: Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Shtëpi  
Investitor: Komuna e Podujevës  
Kontraktuesi: "INTEGRAL" Sh.p.k. Prishtinë  
Nr. i kontraktit: 61516121521  
Data e kontratës: 04.10.2016  
Vlera e kontratës: 63,953.67€  
Data e përfundimit të raportit: 19/12/2016

#### RAPORTI I PRANIMIT TEKNIK PRELIMINAR

Më 17/12/2016 është bërë shikimi i punëve të kryera nga ana e Komisionit për pranimit teknik në projektin e lançuar nga Komisioni në përzierje:

- 1) Harunbe Gjata, inzh. dipl.ark., kryetar
- 2) Mirvete Jaha, inzh. dipl. ndërt., anëtar
- 3) Florio Mami, inzh. dipl.ark., anëtar

Pas kontrollimit të dokumentacionit investivo-teknik, ditë më pas, ishte bërë për tampion (ngjashmësi) dhe sisteme për asfalt si dhe kontrollimin e punëve të kryera në vendpunësim të kontratës së kryerjes në projektin Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Shtëpi në fshatin Shtëpi është bërë në mënyrë kreative sipas kontratës.

Ajeti në fshatin Shtëpi është bërë në mënyrë kreative sipas kontratës. Andaj i sugjeronet investitorit që të bëjë pagosën sipas situacionit të punëve të kryera të paraqitura nga Menaxheri i projektit.

Komisioni për pranimit teknik sugjeron Departamentin e Prokurimit që para se bashkohet garancioni të vlerës kontraktore të bëhet pranimit teknik përfundimtar i projektit.

Menaxheri i projektit:

Shemsedin Latifi, inzh. dipl., ndërt.

*[Signature]*

Komisioni

1) Harunbe Gjata

2) Mirvete Jaha

3) Florio Mami

*[Signatures]*

**Përgjigje në Pretendimi nr. 2,** Operatori ekonomik ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, pretendon se CV-it e Inxhinierëve të ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ati të makinerisë drejtimi konstruktiv dhe Inxhinierit të elektros drejtimi energjetik janë të pa nënshkruara.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierëve”. Andaj, CV-it e inxhinierëve të cekur më latë janë në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimin për kontratë, si dhe askund në dispozitat ligjore nuk thuhet që CV-it duhet të jenë të nënshkruara.

**Përgjigje në Pretendimi nr. 3,** Operatori ekonomik ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, pretendon se Inxhinieri i Hidroteknikës dhe Inxhinieri i Elektros, e ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet: “Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit”.

Eksperti shqyrtues sqaron se NUK janë të qëndrueshme pretendimet e OE ankues në lidhje me referencat, për më tepër referohuni Referencave të prezantuara më poshtë.

**ELECTRA**

**REFERENCË**

**Data:** 05/05/2019

**Z. Gani Zeqiri, Ing. Dip.Ele** ka filluar punën në kompaninë time në vitin 2015 si Menaxher i Operimit. Ai gjatë realizimit të projekteve në kompaninë time, ka shfaqur një aftësi të madhe profesionale dhe të gjitha punët e projekteve i ka realizuar brenda afatit të caktuar kohorë. Nder projektet kryesor në subjekte të ndryshme ka qenë në cilësinë si Menaxher i projekteve dhe që i ka realizuar me sukses janë:

1. Projekti i Ndrëgjimit segmenti C1, C dhe C1-D në Autostradën Arber Xhaferi. **BECHTEL & ENKA** me datë 2015 dhe në vlerë prej 596,730.97 €
2. Modernizimi i ndriçimit publik në komunën e Graçanicës. **UNSAID** me datë 20.01.2016 dhe në vlerë prej 32,655.10 €
3. Projekti i Parkut Gjenerues me TËRËKHTIA 32.5MW, NS Këthia 110/20kV, Fusha Ladhese 110kV, Berritovcë. **Air Energy SH.P.K** me datë 2017-2018 dhe në vlerë 3,989,127.01 €

**Z. Gani Zeqiri** është një individ shumë i vetë-motivuar, efikas, i pavarur dhe i aftë për arritjen e çfarëdo qëllimi që ai e ka në mendje. Aftësia e tij për të komunikuar me udhëheqësit dhe punëtorët e kompanisë, si dhe rregullatorët dhe zyrtarët qeveritarë është mjaft e fortë dhe bindëse, gjë që konsiderohet pastrë për kompani time.

Nëse keni nevojë për informacione shtesë, ju lus që pa hezitim të më kontaktoni në adresën e mëposhtme: [info@electra-ks.com](mailto:info@electra-ks.com)

Me respekt,

Valon Gashi

Menaxher Financiar, **ELECTRA SH.P.K.**

Contact Info  
Address: Mashunaj, Vushtri  
Republika e KOSOVES  
Tel: +386 (49) 126 495  
Email: [hajraktari@shpk@yahoo.com](mailto:hajraktari@shpk@yahoo.com)

04.05.2019

Me kërkesë të z. Sokol V. XHAFA dhe në bazë të dokumentacionit që posedon BAJRAKTARI SH.P.K. me seli në Mashunaj Vushtri lëshon këtë:

#### REFERENCE

Me të cilën dëshmon se z. Sokol V. XHAFA master i shkencave në Hidroteknikë me numër të ID-së 2030491307 me banim në Vushtri ka punuar në kompaninë time prej datës 01.06.2009 deri më 31.12.2009 për të vazhduar pastaj nga 01.01.2013 deri edhe vazhdon të punoj në pozitën: Menaxher i projektit.


Gjatë kësaj periudhe kohore z. Sokol V. XHAFA ka treguar aftësi të shkëlqyera në kryerjen e detyrave dhe mbikëqyrjen e projekteve të:

Emri i projektit	Vlera e projektit	Pozita
Ndërtimi i ligërit akumulues në lumin Iber	948,630.50 €	Menaxher i projektit
Anëks: Kontrata Ndërtimi i ligërit akumulues në lumin Iber	92,493.40 €	Menaxher i projektit

Po ashtu z. Sokol V. XHAFA është i përkushtuar i përpikët gjatë orarit dhe i aftë për punë shpejtë.

Përmes kësaj reference ne u sugjerojmë institucioneve dhe kompanive tjera që mos të hezitojnë në bashkëpunim me z. Sokol V. XHAFA.

Z. Mustaf Bajraktari  
Drejtor



Tel: 049 126 495

**Përgjigje në Pretendimi nr. 4,** Operatori ekonomik ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, pretendon se Inxhinieri i Hidroteknikës, z. Sokol (Veli) Xhafa, në kohen kur e ka lidhë kontratën me OE të rekomanduar për dhënie të Kontratës ka qenë Drejtor Teknik në Ujësjellësin e Prishtinës, ndërsa tash është Kryeshef Ekzekutiv i KUR.



Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi Vepër për aktivitetin në fjalë, ku kontrata është e lidhur në mes të punëdhënësit Misim Aliu dhe punëmarrësit Sokol (Veli) Xhafa, kontrata është e nënshkruar nga të dy palët, është e vulosur, është e lidhur me dt:21.02.2019, andaj kjo kontratë si e tillë mendoj se nuk është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore.

**Përgjigje në Pretendimi nr. 5,** Operatori ekonomik ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka kontratë me kompaninë gjeodezike për shërbime gjeodezike, mirëpo nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe ka kontratë me kompaninë gjeodezike e jo me gjeodetin si është kërkuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtës dhe inxhinierëve”.

Lideri i konsorciumit të Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK”, ka Marrëveshje kontraktuale biznesore me “NSH GJEODETI”, ku kjo marrëveshje është lidhur me dt:12.10.2019, marrëveshja është e noterizuar, janë Certifikatat e Biznesit dhe Numrit fiskal në emër të “NSH GJEODETI”, dhe z. Nehat Sahiti , si dhe Diploma, CV-ia, Licenca dhe Referenca në emër të të njëjtit.

**Përgjigje në Pretendimi nr. 6,** Operatori ekonomik ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës i ka ofruar disa Kontrata gjenerale për furnizim me beton, zhavorr dhe asfalt, e të cilat kontrata janë para njoftimit për kontratë dhe nuk janë të specifikuara që janë për këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur O. E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim”.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, në dosjen e tenderit i ka ofruar Marrëveshjet për furnizim me Zhavorr dhe Beton të lidhura me dt:01.04.2019, në mes “NTSH DINO” SHPK dhe “MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, të cilat janë valide deri me 31.12.2022, këto marrëveshje janë të noterizuara, si dëshmi i janë bashkangjitur Certifikata e Biznesit, lejet



dhe Licencat të lëshuara nga autoritetet përkatëse. Gjithashtu, në dosje është ofruar Marrëveshja mbi furnizim me Asfalt e lidhur me dt:17.06.2019, në mes të “ETI” SHPK dhe “INTEGRAL SHPK”, dhe e cila është valide deri me dt:31.12.2022, marrëveshja është e noterizuar, dhe si dëshmi i janë bashkangjitur Certifikata e Biznesit dhe Licenca e lëshuara nga autoritetet përkatëse, si dhe askund NUK shkruan se Marrëveshjet duhet të jenë për aktivitetin përkatës.

Autoriteti kontraktues i përgjigjet OE ankues “SABA BELCA Dega në Kosovë & SB CONSTRUCTION SHPK & GURËBARDHI SHPK”, tek Vendimi për Refuzim të kërkesës për rishqyrtim me këtë përgjigje: Së pari ashtu si që e keni paraqitur edhe ju kërkesa e pikës 9.2 nga FDT-ja ka qenë që OE-ik duhet të ketë realizuar kontrata të ngjashme (të ndërtimit të ulët) në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Dita e publikimit të njoftimit për kontratë ka qenë 03.12.2019 dhe nga kjo rrjedh se perioda për kontratat e pranueshme është nga data 03.12.2016 deri me datën 03.12.2019 dhe sipas kësaj pretendimi juaj se referencat e datave 19.12.2016 dhe 20.12.2016 janë të pa pranueshme është krejtësisht i pa bazuar. Lidhur me këtë dua t’ua sqaroj se në Vendimin për refuzimin e rekomandimit të komisionit për rivlerësim i kam cekur të gjitha referencat e pranueshme me data të pranimit dhe po ashtu janë cekur të gjitha pozicionet e pranueshme nga kontratat me Ministrinë e Infrastrukturës. Pastaj pretendimet tjera tuaja lidhur me kualifikimet dhe angazhimin e stafit janë të pa pranueshme për arsyet në vijim: -Mungesa e ndonjë nënshkrimi edhe nëse paraqet ndonjë devijim kemi të bëjmë me devijime të vogla që nuk kanë rëndësi (sipas nenit 59), ndërsa angazhimi i ndonjë profesionisti me kualifikim më të lartë nuk paraqet asnjë shkelje, përkundrazi është në favor të realizimit më të suksesshëm të projektit. Po ashtu angazhimi i ndonjë eksperti që është i punësuar nuk paraqet asnjë shkelje pasi që nuk ka asnjë dispozitë ligjore që nuk e lejon angazhimin në punë plotësuese. Nga të gjitha analizat e pretendimeve tuaja kam konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka shkelur asnjë nga dispozitat që ju keni pretenduar dhe si të tilla janë të pa qëndrueshme.

Autoriteti kontraktues e ka refuzuar rekomandimin e Komisionit vlerësues me arsyetimin, shih më poshtë:

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë:12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.



Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se grupi i OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i ulët) në vlerë minimale prej 3 milion euro në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Më tej, OE ankues thekson se kërkesa ka qenë: “Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i ulte) në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), si dhe “Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve”. Tutje, OE ankues shton se konsorciumi në ofertën e tyre ka përfshirë edhe kontrata të mirëmbajtjes dimërore që asesi nuk mund të jetë punë e ngjashme, si dhe mirëmbajtje verore. Po ashtu, këto mirëmbajtje hyjnë në kontrata për shërbime dhe jo kontrata punë siç është ky aktivitet i prokurimit. Gjithashtu, shihet se së bashku si konsorcium kanë më pak se 2 milion euro kontrata të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit. Më tej, OE ankues shton se AK ka marrë parasysh edhe disa pozicione të kontratës së mirëmbajtjeve për plotësimin e këtij kriteri mirëpo i ka anashkaluar pa i analizuar edhe shumë kontrata të cilat i ka përfunduar në fund të vitit 2016 duke kërkuar nga kompania situacionet e tyre dhe të shihet se a e plotësojnë kriterin për realizimin e këtyre kontratave brenda 3 viteve të fundit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor sqaron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar për shkak se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, ka prezantuar kontrata të mirëmbajtjes. Pra, autoriteti kontraktues duhet që të ekzaminoj drejtë këto kontrata nëse janë për mirëmbajtje apo të natyrës së punëve të ngjashme sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se kontrata në shumë prej 183,449.69€ dhe kontrata në shumë prej 63,953.67€ nuk janë analizuar nëse e plotësojnë kriterin se janë kryer brenda 3 viteve të fundit. Paneli



Shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që këto kontrata për të cilat pretendon OE duhet të vërtetohet se për cilën periudhë janë dhe a janë brenda afatit sikurse është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, konkretisht në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë)”. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se CV-it e inxhinierëve të ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, atij të makinerisë në drejtimin konstruktiv dhe inxhinierit të elektros drejtimi energjetik janë të pa nënshkruara. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe në dosje të tenderit, konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “CV-a, Diploma, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierëve”.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se inxhinieri i hidroteknikës dhe inxhinieri i elektros, ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet: “Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që këto referenca i ka bashkangjitur eksperti në ekspertizën e tij.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se inxhinieri i hidroteknikës, z. Sokol (Veli) Xhafa, në kohën kur e ka lidhë kontratën me OE të rekomanduar për dhënie të Kontratës ka qenë Drejtor Teknik në Ujësjetllësin e Prishtinës, ndërsa tash është Kryeshef Ekzekutiv i KUR. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në dosjen e tenderit e ka ofruar Kontratën mbi Vepër për aktivitetin në fjalë, ku kontrata është e lidhur në mes të punëdhënësit Misim Aliu dhe punëmarrësit Sokol (Veli) Xhafa, kontrata është e nënshkruar nga të dy palët, është e vulosur, është e lidhur me dt:21.02.2019. Pra, kjo kontratë nuk është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka kontratë me kompaninë gjeodezike për shërbime gjeodezike, mirëpo nuk ka kontratë të specifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, si dhe ka kontratë me kompaninë gjeodezike e jo me gjeodetin si është kërkuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë



dokumentare është kërkuar: “CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierëve”. Në rastin konkret, lideri i konsorciumit të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK”, ka marrëveshje kontraktuale biznesore me “NSH GJEODETI”, ku kjo marrëveshje është lidhur me dt:12.10.2019, marrëveshja është e noterizuar, janë certifikatat e Biznesit dhe Numrit fiskal në emër të “NSH GJEODETI”, dhe z. Nehat Sahiti , si dhe Diploma, CV-ia, Licenca dhe Referenca në emër të të njëjtit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës i ka ofruar disa kontrata gjenerale për furnizim me beton, zhavorr dhe asfalt, e të cilat kontrata janë para njoftimit për kontratë dhe nuk janë të specifikuara që janë për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit, konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: “Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim”. Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, në dosjen e tenderit i ka ofruar marrëveshjet për furnizim me zhavor dhe beton të lidhura me dt:01.04.2019, në mes “NTSH DINO” SHPK dhe “MILENIUM KONSTRUCTION SHPK”, të cilat janë valide deri me 31.12.2022, këto marrëveshje janë të noterizuara, si dëshmi i janë bashkangjitur Certifikata e Biznesit, lejet dhe Licencat të lëshuara nga autoritetet përkatëse. Gjithashtu, në dosje është ofruar marrëveshja mbi furnizim me asfalt e lidhur me dt:17.06.2019, në mes të “ETI” SHPK dhe “INTEGRAL SHPK”, dhe e cila është valide deri me dt:31.12.2022, marrëveshja është e noterizuar, dhe si dëshmi i janë bashkangjitur Certifikata e Biznesit dhe Licenca e lëshuara nga autoritetet përkatëse. Pra, nuk ka qenë kërkesë e AK-së që marrëveshjet duhet të jenë për aktivitetin përkatës.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me natyrën e punëve dhe nëse kontratat e kontestuara janë brenda 3 viteve të fundit sikurse ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Pas sqarimit të natyrës së këtyre kontratave dhe afateve, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Komuna Prishtinë

1x1 OE –“SABA BELCA; SB CONSTRUCTION SH.P.K; GURËBARDHI SH.P.K”- Obiliq

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.